



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit (KPZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keqklasifikime në kategori të ndryshme ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,148,191€, pagesa të cilat janë realizuar përmes ekzekutimit të vendimeve gjyqësore/ përmbartimore.
- B2 Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në raportin vjetor financiar ishin nënvlerësuar për 355,098€.
- B3 Mos raportimi i pasurive jo financiare në PFV si dhe mos mbyllja e investimeve në vijim.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Prizrenit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Në dy (2) raste janë identifikuar mospërputhje të sasive të shpenzuara bazuar në peshën e dhënë në dosje të tenderit.
- A2 Mos respektimi i kushteve të pagesës sipas kësteve për leje ndërtimit.
- A3 Mospërdorimi i procedurës së duhur të prokurimit.
- A4 Mungesë e dokumentacionit financiar për urdhrat përmbartimor të ekzekutuar në vlerë 3,884,852€.
- B4 Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare.
- B5 Në 19 raste, faturat në total prej 1,294,286€, kishte vonesa në pagesë prej një (1) deri 516 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar kishin të bënin me prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve, nënvlerësimi i regjistrit tek fusha e pasurive, dhe nënvlerësim i regjistrit të llogarive të arkëtueshme. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte dobësi në iniciimin e projekteve pa mbulesë të fondeve, mos përputhje e sasive të realizuara me ato të peshuara si dhe vonesa në pagesën e faturave.

Po ashtu janë identifikuar dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, si dhe mospërdorim të modulit për menaxhim të kontratave në e-prokurim. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Bazuar në të dhënat e Thesarit, shuma totale e pagesave të realizuara në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore për vitin 2025 është 12,695,071€. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 14 rekomandime, gjashtë (6) janë rekomandime të reja, tetë (8) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

##### Gjetja

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarrimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat, në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet ti marrin brenda kufijve të ndarë buxhetor për komunat, duke përjashtuar kategorinë paga dhe shtesa.

Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,148,191€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas urdhrave përmbarrimor të gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 1,419,064€, dhe nga investime

kapitale 729,127€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

**Ndikimi** Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, shpiten në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të merr parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme**

**Gjetja** Rregullorja Nr. 01/2017 për raportimin vjetor financiar, neni 16 “Raport për të arkëtueshmet” parasheh: organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave, po ashtu neni 6 përcakton se organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjisllacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në nenin 16 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) në vlerë 29,277,478€, ishin të nënvlerësuara për 355,098€, pasi që drejtoria e urbanizimit nuk i kishte raportuar saktë llogarit e arkëtueshme nga lejet e ndërtimit.

Deri te mos prezantimi i saktë i shumës totale të llogarive të arkëtueshmeve ka ndodhur si rezultat i neglizhencës nga zyrtarët përgjegjës të drejtorisë së urbanizimit.

**Ndikimi** Prezantimi i llogarive të arkëtueshmeve në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e RVF-së të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën llogarive të arkëtueshmeve.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në RVF.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Mos raportimi i pasurive jo financiare në PFV si dhe mos mbyllja e investimeve në vijim.****Gjetja**

Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, paragrafi 3 përcakton që; “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.” Më tutje neni 11 specifikon se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.

Në auditimin e pasurive jo financiare kemi identifikuar se, shtatë (7) pagesa në vlerë 839,226€ që ishin në fazën e investimeve në vijim dhe ende nuk ishin përfunduar, nuk ishin prezantuar, raportuar tek Raporti Vjetor Financiar (RFV), duke rezultuar në nënvlerësimin të pasurive. Këto pasuri ishin për investime kapitale në infrastrukturën publike.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se akoma ka të regjistruara pasuri në kategorinë investime në vijim për vitet 2013 deri në vitin 2023 në vlerë totale 47,270,834€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistra si pasuri në vijim.

Kjo kishte ndodhur si rezultat mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme, ku zyrtarët përgjegjës kishin regjistruar pasuritë e blera por nuk ishin përfshirë në regjistrin kontabël, ku kjo pastaj ka ndikuar në raportim jo të saktë të vlerës së pasurive në PFV.

**Ndikimi**

Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale ndikon në nënvlerësim të pasurive dhe rezulton në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare vjetore. Po ashtu regjistrimi jo i duhur në procesin e përmbylljes së investimit kapital ka ndikim në vlerën e shpalosjes financiare të pasurive kapitale si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pasurive, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Mos përputhjes të sasive të realizuara sipas çmimit për njësi të peshuar dhe sasisë së realizuar

#### Gjetja

Rregullorja Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik paragrafi 54.15 përcakton se: Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët, dhe në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Po ashtu, sipas interpretimit të KRPP-së së datës 09.06.2023, gjatë realizimit të Kontratës Publike Kornizë - Shërbime, Ofruesi i Shërbimeve, faturimin e bënë duke u bazuar në shërbimet e kryera dhe çmimet për njësi të shërbimeve të kontratës (jo çmimeve të peshuara), por nuk lejohet të kaloj vlerën sipas kategorive dhe vlerën totale të parashikuar të kontratës.

Tek kontrata publike kornizë me çmim njësi "Mirëmbajtja dhe mbjellja e druve dekorative në komunën e Prizrenit" me vlerë të parashikuar 210,000€, kemi vërejtur se ka mos përputhje sipas pozicioneve të dhëna në bazë të peshimit dhe realizimit të punimeve. Te kategoria e I që përfshin "Tre pozicione, 1. Prerja e asfaltit, 2. Prerja e drunjëve ekzistues dhe 3 Furnizimi dhe montimi i anësorëve" ishte peshuar 20% apo 42,000€ e vlerës së parashikuar, ndërsa ishte realizuar vetëm 7,681€, kategoria e II që përfshin 36 pozicione "Furnizimin dhe mbjellja e llojeve të ndryshme të drunjëve dhe tjera" ishte peshuar me 50% apo 105,000€ derisa ishte shpenzuar 196,980€ apo 96% e vlerës së parashikuar, dhe Kategoria e III që përfshin " Tre pozicione për rregullimin e konstruksionit nga metali tri modele" ishte peshuar me 30% apo 63,000€ ndërsa ishte vetëm 649€. Kjo kontratë ishte realizuar në shumë prej 205,311€, ndonëse kontrata në total nuk është tejkaluar por kjo ka ndikuar në mos arritjen e qëllimit të planifikimit dhe kontraktimit gjatë realizimit për këto punë; dhe

Në kontratën publike kornizë me çmim njësi "Hartimi i projektit për kolektorët kryesor të qytetit të Prizrenit" me vlerë të parashikuar 100,000€, pozicioni i pestë (V) që përfshin "Studimi i fizibilitetit dhe detalimi i projektit për kanalizimet e reja të cilat nuk kanë qënë të përfshira në studimet paraprake". ishte peshuar me 5% të vlerës së kontratës që i lejohet të shpenzohet në vlerë 5,000€, ndërsa ishte tejkaluar duke u realizuar 85,094€ apo 85% e vlerës së kontratës gjatë realizimit.

Këto tejkallime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave, përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit dhe mungesës së kontrollit nga menaxherët e kontratave gjatë zbatimit të kontratës.

#### Ndikimi

Tejkallimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo po

ashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore dhe mosrealizimin e kategorive tjera të peshuara sipas kontratës.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, të bëhet një vlerësim i saktë i nevojave reale të komunës gjatë përgatitjes së kërkesave për tender dhe peshat e specifikuar në dosjet e tenderit të reflektojnë rëndësinë dhe vëllimin e pritshëm të shërbimeve që do të kryhen në praktikë. Gjatë zbatimit të kontratës, menaxherët e kontratave të monitorojnë zbatimin sipas peshave të miratuara, për të garantuar përputhshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe objektivat buxhetore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Mos respektimi i kushteve të pagesës sipas kësteve për leje ndërtimit**

**Gjetja** Bazuar në vendimin Nr. 660689 e datës 08.01.2020 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, mënyra e taksës administrative të pagesës për leje ndërtimit, leje rrënimin dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në komunën Prizrenit, janë parapare kushtet e pagesës këste ku neni 5 ka paraparë që taksa administrative e cila tejkalon shumën 100,000€, të paguhet në katër këste dhe afati i përmbushjes së obligimeve sipas nenit 6 është parapare në afat prej 18 muajsh.

Kemi identifikuar në katër raste (4) <sup>1</sup> të lëshimit të lejeve ndërtimore komuna ju kishte mundësuar aplikuesve që pagesën ta kryejnë me këste, mirëpo kjo nuk është respektuar nga ana e tyre dhe nuk ju kanë përmbajtur kushteve të marrëveshjes. Më tutje nuk ishin marrë veprimet nga ana e zyrtarëve përgjegjës që obligimet të kryhen.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve jo adekuate nga zyrtarët përgjegjës të komunës, pasi komuna nuk ka paraparë ndonjë ndëshkim në rast të vonesës së pagesës nga investitori.

**Ndikimi** Mos pagesa sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara sipas vendimit të lartcekur, rrit rrezikun e mos përmbushjes së objektivave financiare dhe realizimin e projekteve të planifikuara.

**Rekomandimi A2** Kryetari i komunës duhet të sigurojë se do të ndërmerr veprimet ligjore dhe administrative për të gjithë ata atë cilët nuk kanë përmbushur obligimet e tyre me kohë dhe të veproje, duke ndërrmarë hapa/mekanizma ligjor për arkëtimin e të arketueshmeve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A3 - Mospërdorimi i procedurës së duhur të prokurimit****Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 54 pika 54.15 Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve/artikujve" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime. Kërkesat nga ky paragraf duhet të vendosen në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Te kontrata "Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura, kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit" me çmim për njësi 5,978.10€, dhe me vlerë të parashikuar 3,000,000€, gabimisht kishte përdorur llojin e kontratës publike kornizë çmim për njësi për punë. Kontrata publike kornizë me çmime për njësi mund të udhëhiqen vetëm për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime, por jo edhe për punë, që me rastin e projektimit për punë të planifikohen sasi të paramasës dhe parallogarisë në bazë të vendndodhjeve të sakta të realizimit të projektit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme prej inicimit të kërkesës nga njësia kërkuese dhe zyra e prokurimit, për ti respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike për punë.

**Ndikimi**

Përdorimi I gabuar I llojit të kontratës publike kornizë me çmim për njësi për punë, në raport me projekte me paramasë të sasive të planifikuara - kontraktuara, mund të ndikon që realizimi i projektit të jetë joekonomik dhe jo transparent në raport me konkurruesit apo palët e interesit.

**Rekomandimi A3**

Kryetari duhet të siguroj që me rastin e kontraktimeve të projekteve kapitale për punë të përdor procedurën e duhur të prokurimit, të kontraktohen më paramasë dhe parallogari të sasive të planifikuara në mbështetje të projektit kryesor.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja A4 - Mungesë e dokumentacionit financiar për urdhrat përmbarimor të ekzekutuar****Gjetja**

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - shpenzimi i parave publike, neni 26 paragrafi 1 përcakton, se asnjë që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e LMFP. Tutje paragrafi 2 përcakton dokumentet që kërkohen për procedimin e pagesave.

Në auditimin e lëndëve të shpenzimeve gjyqësore në kategoritë ekonomike të ekzekutuara në bazë të listës së urdhrave përmbarimor nga thesari për personat juridik dhe fizik, në 30 mostra të urdhrave përmbarimor të ekzekutuar në vlerë totale 3,884,852€, nuk na është ofruar dokumentacioni

financiar mbështetës (Propozimet urdhërat përmbarimor, faturat, raportet e pranimit - situacioneve të punëve, shërbimeve të kryera dhe kontratat).

Kjo ka ndodhur si shkak i mosfunksionimit të duhur të kontrollit të brendshëm të komunës, dhe moskordinimit në mes të drejtorive që janë përgjegjëse për ti ofruara dokumentacionin apo dëshmitë burimore.

**Ndikimi** Mungesa e dokumentacionit mbështetës për ekzekutimin e urdhrave përmbarimor të ekzekutuar, rrit rrezikun që të ekzekutohen pagesa pa u kryer punët apo shërbimet.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë që më rastin e propozim përmbarimit nga përmbaruesi, që lenda është e mbuluar me dokumentacionin e plotë mbështetës financiar dhe gjatë procesit të auditimit të ju ofrohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar auditorëve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B4 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare

**Gjetja** Ligji i prokurimit publik Nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 përcakton se, "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla". Po ashtu Ligji i Buxhetit nr. 08/L-332 për vitin 2025, neni 12 paragrafi 7 përcakton se; "Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim".

Kontraktimet e projekteve në vitin 2025 në mungesë të buxhetit janë identifikuar në këto raste si në vijim:

- Kontrata "Renovimi i bibliotekës ndërkomunale në Prizren" në vlerë të kontraktuar 1,488,938€ është kontratë pune investim kapital e cila nuk është e paraparë në buxhetin e kategorisë së investimeve kapitale; dhe
- Kontrata "Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave në zonën e parë të objekteve të mbrojtura , kryesisht në pjesën e vjetër të qytetit të Prizrenit" në vlerë të kontraktuar 3,000,000€ me çmim për njësi 3,412.33€ ndërsa në PIP ka pasur mjete në vlerë 2,450,631€ nga kjo rezulton në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 549,369€.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

**Ndikimi** Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale,

nënshkrimi i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare, rrit nevojën për ridestinime buxhetore për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve si dhe rrezikun e kostove shtesë.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumatat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave**

**Gjetja** Neni 39.1 i LMFPP përcakton se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në 19 raste, faturat në total prej 1,294,286€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave ishin nga një (1) deri 516 ditë kalendarike.

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur fonde buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

**Ndikimi** Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna të mos i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte në vlerë 29,870,058€ deri sa realizimi ishte 29,811,601€.

#### Çështja A5 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik

**Gjetja** Rregullorja (QRK) Nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil neni 34 përcakton “Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje”. Po ashtu neni 102 pika i Ligjit nr. 08/l-197 për zyrtarët publik përcakton “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtarëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës”.

Komuna ende nuk e ka hartuar rregulloren për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, si parakusht për harmonizimin e kontratave të punës me kuadrin e ri ligjor. Nga 70 kontrata të testuara, në 25 raste kontratat nuk ishin të azhurnuara sa i përket koeficienteve dhe elementeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zyrtarët publik.

Kjo ka ardhur si rezultat i mos hartimit me kohë të rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, e cila paraqet një kusht paraprak për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë në aspektin e kontratave dhe koeficienteve të ri.

**Ndikimi** Mos azhurnimi i kontratave të punës dhe mospërputhja me sistemin e ri të koeficienteve ka shkaktuar mosrespektim të kërkesave ligjore dhe ka ndikuar në mos përfshirjen e saktë të pozitave në strukturën e pagave.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr veprime miratimin e rregullores për sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës, me qëllim mundësimin e azhurnimit të kontratave të punës në përputhje me Ligjin për Zyrtarët Publik.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra, shërbime dhe komunalitë ishte 15,526,686€, prej tyre ishin shpenzuar 15,381,577€. Ato kanë të bëjnë kryesisht shpenzimet e mirëmbajtjes, sigurime të ndërtesave, vendime gjyqësore/përmbartimore, shpenzime kontraktuese tjera, shpenzime të derivateve etj.

#### Çështja A6 - Paqartësi në kërkesat e shpalljes së tenderit për blerjen e dy autoambulancave

**Gjetja** Bazuar në njoftimin për kontratë të datës 28.05.2025 dhe dosjen e tenderit, ku parasheh “Blerjen e dy autoambulancave për nevojat e shëndetësisë primare” në kuadër të pikës II.1.7 të Variantet nuk pranohen dhe pikës III.2.4 kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa 7 Atesti i konvertimit të veturës në autoambulancë.

Në kontratën për “Furnizim me dy autoambulanca për nevojat e shëndetësisë primare” në vlerë 139,450€, Komuna bazuar në kërkesat e parapara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit kishte vendosur kërkesat të paqarta-kundërta, ku në njërin anë nuk ka lejuar variantet përkatësisht modifikimin ndërsa të kërkesat e kapacitetit teknik profesional ka kërkuar atest të konvertimit të veturës në autoambulancë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së funksionimit të kontrolleve të brendshme apo neglizhencës nga ana e zyrtarëve përgjegjës dhe mungesa e monitorimit nga zyra e prokurimit.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i kërkesave në shpalljen e njoftimit për kontratë dhe kërkesave teknike profesionale nga ana e autoritetit kontraktues mund të ndikojnë në shkeljen e transparencës duke pasur parasysh se operatorët tjerë përkatësisht ofertuesit konkurrues të mos ofertojnë nga paqartësia e mos lejimit të varinacave në rastin konkret për furnizimin e me dy autoambulanca.

**Rekomandimi A6** Kryetari duhet të sigurojë dhe të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës të prokurimit që me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit të përfshijë të gjitha kërkesat e qarta dhe të detajuara duke kontribuar në një proces të prokurimit me të rregullte dhe në interes të komunës dhe interesit publik.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 24,937,210€, prej tyre ishin shpenzuar 22,989,212€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me investimet në infrastrukturën rrugore, vendime gjyqësore / përmbartimore, ndërtimin e kanalizimeve, trotuareve, ndërtimin e objekteve arsimore, shëndetësore etj.

#### **Çështja B6 - Mungesë e informatave të plota për menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike**

##### **Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 pika (f) thekson se menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin të prokurimit elektronik”.

Menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar me informata të plota menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktueseve në modulën përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

##### **Ndikimi**

Mungesa e plotë e të dhënave të menaxhimit të kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

##### **Rekomandimi B6**

Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 516,354,177€, pasurive jokapitale është 2,754,520€, si dhe e stoqeve 288,076€.

#### Çështja B7 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

**Gjetja** Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: “Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Po ashtu neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare”, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare duke mos përfshirë të gjitha drejtoritë e komunës (arsimin dhe shëndetësinë) në raportin e inventarizimit, tutje nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive me regjistrat kontabël rrjedhimisht nuk dihet diferencat në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare që kanë të bëjnë me vlerësimin e pasurive të dëmtuara, vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurive si dhe përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi.

Kjo gjendje ishte për shkak të mosfunksionimit të kontroleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzuesëve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

**Ndikimi** Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit, regjistrimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.5 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arketueshme të prezantuara në PFV të vitit 2025 në total janë 29,217,478€. Saldo e të arketueshmeve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, taksat për leje ndërtimi, taksat për biznese, qiraja nga shfrytëzimi i pronave komunale dhe të tjera.

#### Çështja B8 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme

##### Gjetja

Ligji Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 26 përcakton se “Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove”. Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.

Në vitin 2025, totali i llogarive të arkëtueshme të komunës arriti në 29,217,478€, duke shënuar një rritje nga viti paraprak për 1,928,313€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (51%), taksës nga mbeturinat (23%), taksës për leje ndërtimi (14%), taksës për bizneset (9%) dhe qirasë për shfrytëzimin e pronës publike (3%). Në bazë të testimit kemi vërejtur se në 25 raste komuna nuk kishte marre masa të nevojshme për mbledhjen e borxheve ndonëse afati për inkasim ishte tejkaluar.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pa-mjaftueshme ligjore përmes përmbaruesit në arkëtimin e të hyrave sipas afateve.

##### Ndikimi

Mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arketueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.

##### Rekomandimi B8

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>6</sup>	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>70,352,476</b>	<b>75,127,895</b>	<b>72,939,420</b>	<b>68,794,278</b>	<b>62,409,458</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	58,251,699	60,561,144	60,310,023	55,482,599	50,062,613
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,500,000	1,500,000	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,205,617	1,204,286	3,200,908	4,366,480
Të hyrat vetanake	10,600,777	10,600,777	10,532,531	9,312,646	7,885,742
Donacionet vendore	0	330,600	214,390	466,927	72,273
Donacionet e jashtme	0	929,756	678,190	331,197	22,349

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 4,775,419€. Kjo rritje është rezultat nga granti qeveritar në bazë të Vendimit të Qeverisë për 2,309,445€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 1,206,617€, si dhe donacioneve 1,260,356€.

Në vitin 2025 komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar ose 72,939,420€, me një përmirësim 1% në krahasim me vitin 2024. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>70,352,476</b>	<b>75,127,895</b>	<b>72,939,420</b>	<b>68,794,278</b>	<b>62,409,458</b>
Pagat dhe mëditjet	27,492,932	29,870,058	29,811,601	27,419,172	25,709,009
Mallrat dhe shërbimet	14,240,224	14,447,589	14,312,038	12,581,586	11,829,897
Komunalitë	1,055,299	1,079,097	1,069,539	821,081	1,570,749
Subvencionet dhe transferet	4,561,785	4,793,941	4,757,031	4,149,398	3,537,966
Investimet Kapitale	23,002,236	24,937,210	22,989,212	23,823,042	19,761,836

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 2,377,126€. Kjo rritje është si rezultat i rritjes së koeficienteve të pagave;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar të kategoria e mallra dhe shërbime ishte rritur për 207,365€.
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar të kategoria shpenzime komunale ishte rritur për 23,798€;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar të kategoria subvencine dhe transfere ishte rritur për 232,156; dhe
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar të kategoria e investimeve kapitale ishte rritur për 1,934,974€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e planifikuara për vitin 2025 ishin 10,600,777€, ndërsa janë realizuar 9,414,447€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2025 Komuna e Prizrenit ka përfituar të hyra nga gjobat në trafik në vlerë 2,654,173€ dhe gjykatave në vlerë 121,512€ si dhe të hyrat nga Agjencioni i pyjeve në vlerë 15,381€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme pasi që të njëjtat i planifikohen dhe realizohen nga komuna, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>10,600,777</b>	<b>10,600,777</b>	<b>9,414,447</b>	<b>8,406,771</b>	<b>9,579,478</b>
Të hyrat tatimore	3,833,328	3,833,328	2,871,065	2,511,507	3,580,180
Të hyrat jo tatimore	6,767,449	6,767,449	6,540,938	5,892,462	5,999,299
Të hyrat tjera	0	0	2,443	2,802	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2024 për Komunën e Prizrenit ka rezultuar me 12 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2024 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Prizrenit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, katër (4) rekomandime janë zbatuar, tetë (8) rekomandime nuk kanë filluar të zbatohen ende, siç janë paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve në mënyrë që detyrimet kontingjente të shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të mbështetura në dokumentacion të nevojshëm për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2025.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në PFV.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e subvencionimit të OJQ-ve të respektohen kufizimet e rregullores për numrin e përfitimeve brenda një viti dhe fondet të ndahen vetëm për OJQ-të që i plotësojnë kriteret e përcaktuara.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2025.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit sa i përket përgatitjes me dokumentacionin e plotë të nevojshëm para inicimit dhe kontraktimit të projekteve. Në rastet e revidimit të projektit, duhet të përshtatet specifikacioni teknik i ri dhe i njëjti të aprovohet nga OE, në mënyrë që të shmangen humbjet potenciale nga mosrespektimi i procedurave.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2025.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit në aspektin teknik, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2025.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulën përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të kostove financiare në fazën e buxhetimit, duke siguruar që për çdo projekt kapital, para fillimit të procedurave të prokurimit, të jenë të parashikuara fonde të mjaftueshme në Ligjin e Buxhetit dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë planifikime të mirëfillta buxhetore sipas natyrës së shpenzimeve, ashtu që shpenzimet të paguhen dhe regjistrohen nga buxheti i kategorive përkatëse, në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin e pasurive, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit




Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren- Prizren Belediyesi

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Shaqir Totaj

Kryetar i Komunës së Prizrenit

Data: 03.06.26, Prizren



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>7</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>8</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Më datën 30.11.2022 ishte dhënë leja e ndërtimit në shumë prej 118,070€, ishte paguar vetëm kësti i pare 35,421€ (30% nga leja e ndërtimit). Në fund të vitit 2025 kishte mbetur si llogari e arkëtueshme shuma prej 82,649€, ndonëse sipas kushteve të përcaktuara obligimi i palës që është pajisur me leje do duhej të bëhet deri në maj të vitit 2024; Më datën 18.01.2023 ishte dhënë leja e ndërtimit në shumë prej 151,299€, ishin paguar kësti i parë dhe i dytë në shumë prej 83,215€ (30% dhe 25% sipas së lejes së ndërtimit). Në fund të vitit 2025 kishte mbetur si llogari e arkëtueshme shuma prej 68,084€, ndonëse sipas kushteve të përcaktuara obligimi i palës që është pajisur me leje do duhej të bëhet deri në qershor të vitit 2025; Më datën 30.11.2022 ishte dhënë leja e ndërtimit në shumë prej 443,882€, ishte paguar vetëm kësti i parë 133,164€ (30% sipas shumë së lejes së ndërtimit). Në fund të vitit 2025 kishte mbetur si llogari e arkëtueshme shuma prej 310,718€, ndonëse sipas kushteve të përcaktuara do duhej të bëhet deri në dhjetor 2025; dhe Rasti tjetër ishte dhënë leja e ndërtimit në shumë prej 505,068€, ishin paguar kësti i parë në shumë prej 151,520€ (30% sipas shumë së lejes së ndërtimit). Në fund të vitit 2025 kishte mbetur si llogari e arkëtueshme shuma prej 353,548€, ndonëse sipas kushteve të përcaktuara obligimi i palës që është pajisur me leje do duhej të bëhet deri në fund të vitit 2025.
- <sup>6</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>7</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>8</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.